

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6733
E hënë, 17 tetor 2022
çmimi 0.40

Busti i Adem Demaçit do të ndërtohet në qendër të Podujevës

1 FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHASHA: HYRJA E EMIGRANTËVE NË BE NGA BALLKANI PERËNDIMOR, SHKAK PËR KUSHTËZIMIN E LIBERALIZIMIT



Drejtori i Institutit Epik, Demush Shasha, ka thënë se kushtëzimi për liberalizim të vizave për Kosovën i lidhur me funksionalizimin e sistemit për siguri në Evropë, ETIAS, është bërë pasi futja e emigrantëve në shtetet e BE-së përmes vendeve të Ballkanit Perëndimorë është bërë

një problem për BE-në. Duke iu referuar të dhënave nga Frontex, të cilat tregojnë se hyrjet ilegale nga Ballkani Perëndimor për në BE janë rritur për 170 përqind këtë vit, Shasha tha se BE-ja ka ngritur shqetësim ndaj Kosovës për mospërafrimin e regjimit të vizave me regjimin e BE-së

AKTUALE



FRANCA DO TË TRAJNOJË RRETH
2 000 USHTARË UKRAINAS F. 2

CILAT JANË KËRKESAT E REJA PËR
LIBERALIZIMIN E VIZAVE? F. 4

PËRGATITJET PËR DIMËR,
EKSPERTËT THONË SE MASAT
E QEVERISË JANË TË DOBISHME
POR TË PAMJAFTUESHME F. 5

EKONOMI



MEHMETI: PO BËJMË PËRPPJEKJE QË
TË MOS KETË RRRITJE TË NORMAVE
TË INTERESIT NË KREDI F. 7

MUSTAFA PËRMEND DISA NGA
ARSYET E RËNIES EKONOMIKE: VITI
AKTUAL PARASHIHET TË JETË
SFIDUES F. 7

SPORT



BALLKANI REGJISTRON
BARAZIMIN E PARË, LLAPI MERR
NJË PIKË NË MITROVICË, GJILANI
FITON SI MYSAFIR F. 10

OSMANI: NËSE DIKUSH DËMTOHET NGA 'BALLKANI I HAPUR', NE S'DO TË JEMI PJESË E NISMËS

1 FAQE 2



ZBULOHET PLLAKA ME EMRAT
E 15 MATURANTËVE TË
MALISHEVËS QË VDIQËN
TRAGJIKISHT NË FUSHË ARRËZ

1 FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Franca do të trajnojë rreth 2 000 ushtarë ukrainas

PARIS, 16 TETOR - Franca ka njoftuar se do të furnizojë Ukrainën me sisteme të mbrojtjes ajrore dhe do të zgjerojë një program trajnimi për ushtarët ukrainas. Deri në 2 000 ushtarë ukrainas do të përfshihen në njësitë ushtarake në Francë për disa javë trajnime luftarake, trajnime më të specializuara në logjistikë dhe nevoja të tjera, dhe trajnime mbi pajisjet që Franca do t'ia jap Ukrainës, tha ministri i Mbrojtjes, Sebastien

Lecornu, në një intervistë për Le Parisien. "Ne po vërejmë faktin se lufta, mjerisht, do të zgjasë. Një brez i ri ushtarësh duhet gjithashtu të stërvitet", citon gazeta të ketë thënë ministri francez. Franca kishte trajnuar edhe më parë trupat e artilerisë ukrainase për të përdorur obusët vetëlëvizës të Cezarit, që ajo ia kishte dhënë Ukrainës. Ministri tha se bateritë e sistemeve të mbrojtjes ajrore, Crotale, që Franca po përgatit

t'i dërgojë në Ukrainë "do të jenë veçanërisht të dobishme në luftën kundër dronëve dhe bombardimeve ajrore". Ai nuk specifikoi se sa prej tyre do të shkojnë në Ukrainë, por tha se "do të jetë e rëndësishme t'u mundësohet atyre të mbrojnë qiellin e tyre". Në gusht ushtria britanike njoftoi për 120 ditë do të trajnojë 10.000 rekrutë ukrainas në guajtje, dhënien e ndihmës së parë luftarake dhe për betejat në qytete.



Osmani: Nëse dikush dëmtohet nga 'Ballkani i Hapur', ne s'do të jemi pjesë e nismës

SHKUP, 16 TETOR - Ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, tha të dielën në Shkup se nisma e 'Ballkanit të Hapur' synon thellimin e bashkëpunimit mes shteteve të rajonit, por ajo, sipas tij "nuk do të jetë e plotë pa pjesëmarrjen e të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor".

Në një aktivitet me ambasadorin e Kosovës në Shkup, Florian Qehaja, me rastin e 13 vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dyja vendeve, Osmani tha se Maqedonia e Veriut mund të largohet nga 'Ballkani i Hapur' nëse ndonjë nga shtetet do të dëmtohet nga kjo një nismë.

Maqedonia e Veriut ka njohur shtetin e Kosovës më 9 tetor të vitit 2008, ndërsa marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve janë vendosur më 16 tetor të vitit 2009. " 'Ballkani i Hapur' është një nismë organike, një nismë e vendeve të rajonit, që krijon ndjesinë se ne edhe vet mund të bashkëpunojnë pa na ftuar dikush tjetër në ndonjë nismë tjetër. Por, problem i 'Ballkanit të Hapur' është se aty nuk janë të gjitha gjashtë shtetet", tha Osmani, duke shtuar se vlerëson se janë legjitime qëndrimet e tri shteteve tjera që kanë vendosur të mos jenë pjesë e



nismës. "Detyra jonë është që të bëjnë përpjekje që t'i bindim, por ne përmes rezultateve duhet të dëshmojnë se jemi vlerë. Nëse nuk tregojmë rezultate atëherë s'ka se pse dikush të na bashkohet. Ne, si Maqedoni Veriut nuk do të lejojmë që

ndonjë shtet tjetër të dëmtohet. Ne konsiderojmë se nëse dikush do të dëmtohet, mendoj këtu edhe për Kosovën për shkak të pikëpamjeve të saj ndaj kësaj nisme, atëherë ne nuk do të marrim pjesë në këtë nismë. Ne do të jemi gardianë të mbrojtjes së cilit do shtet në

'Ballkanin e Hapur'", ka deklaruar Osmani.

Ai ka thënë se Maqedonia e Veriut i jep mbështetje Kosovës në të gjitha nismat dhe përpjekjet për anëtarësim në institucionet ndërkombëtare si në NATO, Këshillin e Evropës si dhe liberalizimin e vizave

"Maqedonia e Veriut mbështet fuqishëm Republikën e Kosovës në rrugën e njohjeve ndërkombëtare. Ne para disa ditëve i bëmë thirrje Bashkimit Evropian që menjëherë, pa asnjë vonesë të miratoj liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Ne po i japim mbështetje Kosovës edhe në Këshillin e Evropës për pranimin e saj në këtë institucion evropian, por edhe në të gjitha organizatat tjera ndërkombëtare", ka deklaruar Osmani.

Sipas tij, kjo është rruga e vetme për të stabilizuar rajonin që të vazhdojë procesin e anëtarësimit në NATO dhe BE. "Si vend anëtare e NATO-s, Maqedonia e Veriut është e përkushtuar për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe në këtë kuadër i japim mbështetje përpjekjeve të Kosovës që të bëjë pjesë e aleancës", tha ai.

Nisma 'Ballkani i Hapur' është vazhdimësi e Mini-Shengenit ballkanik, e prezantuar në Novi Sad të Serbisë më 10 tetor të vitit 2019, nga liderët e Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.

'Ballkani i Hapur' është thënë se synon të mundësojë lëvizje të lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Kosova, Bosnjë e Hercegovina dhe Mali i Zi nuk janë pjesë e saj.

Irani kritikon Bidenin për mbështetjen e protestave

TEHRAN, 16 TETOR - Irani ka kritikuar presidentin amerikan, Joe Biden, për shprehjen e mbështetjes për protestat që kanë tronditur vendin që kur një grua e re u vra në paraburgim nga policia iraniane. Biden tha se ishte i befashuar nga guximi i njerëzve që dolën në rrugë

në protestat në Iran. "Dua të dini se ne qëndrojmë me qytetarët, gratë e guximshme të Iranit", tha ai më 15 tetor. Teherani tha se kjo përbën ndërhyrje në punët e brendshme të Iranit. "Të shtunën... Biden ndërhyri në çështjet shtetërore të Iranit

duke mbështetur trazirat... Në ditët e fundit, administrata e SHBA-së është përpjekur në mënyrë të dëshpëruar të nxitë trazirat në Iran me justifikime të ndryshme", ka pohuar zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme, Nasser Kanaani, më 16 tetor.



Shasha thotë se hyrja e emigrantëve në BE nga Ballkani Perëndimor, shkak për kushtëzimin e liberalizimit

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 TETOR - Drejtori i Institutit Epik, Demush Shasha, ka thënë se kushtëzimi për liberalizim të vizave për Kosovën i lidhur me funksionalizimin e sistemit për siguri në Evropë, ETIAS, është bërë pasi futja e emigrantëve në shtetet e BE-së përmes vendeve të Ballkanit Perëndimorë është bërë një problem për BE-në.

Duke iu referuar të dhënave nga Frontex, të cilat tregojnë se hyrjet ilegale nga Ballkani Perëndimor për në BE janë rritur për 170 përqind këtë vit, Shasha tha se BE-ja ka ngritur shqetësim ndaj Kosovës për mospërafrimin e regjimit të vizave me regjimin e BE-së. “Keni parë se si në kontekst të liberalizimit të vizave për Kosovën BE-ja ka ngrit shqetësim ndaj Kosovës për mospërafrimin e regjimit të

vizave me regjimin e BE-së? Keni parë se si për të njëjtën arsye BE-ja po konsideron pezullimin e liberalizimit Serbisë? Eh, pra kjo është arsyeja: dhënat e fundit nga Frontex, the European Border and Coast Guard Agency konfirmojnë se numri i hyrjeve ilegale në BE në nëntë muaj të parë të vitit 2022 kanë shënuar rritje prej 70% krahasuar me vitin e kaluar. Ky është rekordi i hyrjeve ilegale në BE-që për nëntë muaj të parë që nga viti 2016; dhe gjysma e këtyre kalimeve ilegale kanë hyrë në BE përmes Ballkanit Perëndimor. Krahasuar me vitin e kaluar kjo është rritje prej 170% të hyrjeve ilegale përmes rajonit tonë. Sirianët dhe afganët kanë qenë shtetësi kryesore migruese”, ka shkruar ai në “Facebook”.

Shasha ka theksuar se sipas Analizës së Riskut Strategjik 2022 të Frontex-it, në skenarët e krizave të mëdha në fqinjësinë e BE-së do të kërkohej shtetësi i kontrollave kufitare në Ballkanin Perëndimor, në veçanti pasi që



i kontrolleve kufitare në Ballkanin Perëndimor. “Vëni tash këto në sfond të analizës së riskut strategjik 2022 të Frontex-it ku në skenarët e krizave të mëdha në fqinjësinë e BE-së do të kërkohej shtetësi i kontrolleve kufitare në Ballkanin Perëndimor”, në veçanti pasi që

‘migrimi në këtë rajon është çështje e brengosjes së veçantë për shkak prezencë së prijëseve fetarë të cilët mirëmbajnë lidhje të afërta me grupet ekstreme fetare në BE’ dhe e kuptoni cila është brenga e BE-së. E gjithë kjo nuk ka të bëjë asgjë ekskluzivisht me Kosovën. Ky është problem i gjithë rajonit.

Kam thënë edhe në maj të këtij viti: sa shpenzojmë energji të panevojshme në diskutimet të llojit Procesi i Berlinit vs Ballkani i Hapur, para vetës kemi një krizë në rritje e cila kërkon vëmendjen dhe bashkëpunimin e të gjitha vendeve të rajonit”, ka shkruar Shasha.

Ramiz Kelmendi vizitoi ish-krerët e UÇK-së në Hagë



PRISHTINË, 16 TETOR - Politikani dhe afaristi Ramiz Kelmendi po qëndron në Hagë të Holandës.

Ai atje ka vizituar ish-krerët e UÇK-së. Këtë e konfirmoi vet përmes një postimi në “Facebook”.

Kelmendi ka thënë se për shkak të çështjeve teknike nuk kishte arritur të takojë vetëm me Jakup Krasniqin, kurse me të tjerët po. “Kam qëndruar për vizitë në Hagë, liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! Takova ish-presidentin e Republikës, Hashim Thaçi, ish-kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ish-Deputetin e Kuvendit të Kosovës, Rexhep Selimi dhe ish-nënkryetarin e OVL të

UÇK-së, Nasim Haradinaj. Keqardhje që për shkak të disa procedurave teknike, krejt legjitime, nuk arrita ta takojë edhe ish-kryetarin tjetër të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi. Qëllimi i vizitës time atje, ishte mbështetja për të përballuar izolimin e padrejtë të tyre”, ka shkruar Kelmendi. Ai ka bërë me dije se që të gjithë janë mirë me shëndet, të shoqëruar e unik, afër njëri-tjetrit siç ishin në luftë. “Të bindur e të paluhatshëm në luftën e drejtë të Kosovës dhe UÇK-së! Përcjellë me këtë rast, përshëndetjet e tyre për kombin shqiptar. Kam dalur nga takimi, i frymëzuar me krenarinë që e kishin”, ka shkruar Kelmendi.

Busti i Adem Demaçit do të ndërtohet në qendër të Podujevës

PODUJEVË, 16 TETOR - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi ka njoftuar se vitin e ardhshëm do ta bëjnë ndërtimin e bustit të Adem Demaçit në qendër të qytetit në Podujevë.

Bulliqi lajmin e bëri me dije në manifestimin letrar të organizuar nga shoqata “Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës”, dega në Podujevë e mbështetur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për nder të ikonës dhe veprimtarit të madh kombëtar, Adem Demaçi. “Me vendosjen e bustit të Adem Demaçit në Podujevë, ne nderojmë

veprimtarinë dhe sakrificën e tij, si dhe lartësojmë historinë e lavdishme të Kosovës drejt lirisë e pavarësisë. Baca Adem është shembulli më i mirë i atdhedashurisë e sakrificës për popullin e tij, ai do të mbetet gjithmonë frymëzim për brezat e ri se si luftohet dhe sakrifkohet për atdheun”, ka theksuar Bulliqi, duke shtuar se baca Adem përveçse veprimtar i paepur i çështjes kombëtare, ishte edhe gazetar, poet e letrar me stil të veçantë të të shkruarit. “Ai ishte krejtësisht original e autentik në mendimet e qëndrimet e tij”, ka thënë Bulliqi.





Cilat janë kërkesat e reja për liberalizimin e vizave?

Deri më 21 tetor, vendet anëtare të BE-së kanë afat që t'i dërgojnë komentet e tyre me shkrim lidhur me liberalizimin e vizave për Kosovën. Kështu kanë thënë burimet diplomatike në Bruksel pas diskutimit të grupit punues të mbajtur javën e kaluar në Bruksel. Por, akoma ka vende, në krye të së cilave është Franca, të cilat duan që vendimin për liberalizimin e vizave, apo hyrjen e tij në fuqi, ta ndërlidhin edhe me disa çështje tjera

PRISHTINË, 16 TETOR - Diskutimet për liberalizimin e vizave për Kosovën do të vazhdojnë në grupin punues të Këshillit të Bashkimit Evropian më 9 nëntor, ndërsa deri atëherë, vendet anëtare do të zhvillojnë edhe konsultime ndërmjet vete.

Po ashtu, deri më 21 tetor, vendet anëtare të BE-së kanë afat që t'i dërgojnë komentet e tyre me shkrim lidhur me liberalizimin e vizave për Kosovën. Kështu kanë thënë burimet diplomatike në Bruksel pas diskutimit të grupit punues të mbajtur të enjten në Bruksel.

Nga ky takim, sipas burimeve të njëjta, është parë se një shumicë e madhe e vendeve anëtare mbështet vendimin për liberalizimin e vizave.

Por, akoma ka vende, në krye të së cilave është Franca, të cilat duan që vendimin për liberalizimin e vizave, apo hyrjen e tij në fuqi, ta ndërlidhin edhe me disa çështje tjera.

Ndër to janë vënia në funksion e sistemit për siguri në Evropë, ETIAS, përshtatja e Kosovës me politikën e vizave të BE-së, rritja e kontrollit të kufijve dhe vazhdimi i riadhesimit të atyre që duhet të lëshojnë territorin e BE-së.

ETIAS është sistem evropian për autorizim dhe informacione rreth udhëtimit, por ky sistem akoma nuk është funksional.

Në atë sistem, qytetarët e shteteve për të cilat janë liberalizuar vizat, duhet të regjistrojnë të dhënat e tyre para se të udhëtojnë në BE. Atëherë do të marrin konfirmimin elektronik dhe kjo do të vlejë për tre vjet.

Hyrja në fuqi e këtij sistemi është shtyrë disa herë për shkaqe teknike Ai pritet të hyjë në fuqi në fillim të vitit të ardhshëm, por do të bëhet plotësisht funksional më 1 nëntor të vitit 2023.

Prandaj, kërkesa e Francës, sipas disa interpretimeve të diplomatëve, do të mund ta

shtynte hyrjen në fuqi edhe të vendimit për liberalizimin e vizave për Kosovën deri në nëntor të vitit që vjen.

Burimet diplomatike të BE-së i kanë thënë Radios Evropa e Lirë se një varg shtetesh dhe Komisioni Evropian e konsiderojnë të panevojshme dhe të paarsyeshme ndërlidhjen e procesit të liberalizimit të vizave me sistemin ETIAS.

Këto vende dhe Komisioni, sipas këtyre burimeve, kanë argumentuar se ETIAS është një sistem teknik, hyrja e të cilit në fuqi varet nga gatishmëria teknike e vetë BE-së.

Disa shtete, e në mesin e tyre përmendet Holanda, Belgjika, Suedia dhe Spanja, kanë shprehur mirëkuptim për këtë propozim të Francës, por shumë shtete tjera, përfshirë edhe Gjermaninë, e kanë kundërshtuar.

Në këtë takim disa shtete nuk kanë shprehur qëndrim, e në mesin e tyre janë Qipro, Rumania dhe Sllovakia, të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Greqia, që po ashtu nuk e ka njohur Kosovën, është shprehur fuqishëm dhe pa rezerva në favor të liberalizimit të vizave. Edhe Spanja nuk e njeh Kosovën dhe nuk ka shprehur qëndrim, por ka bërë të ditur se ajo do të pajtohet me vendimin e shumicës.

Disa vende, të cilat nuk e kanë

shprehur qëndrimin në këtë takim, janë arsyetuar me faktin se kanë pasur zgjedhje dhe janë në pritje të formimit të qeverisë. Ato janë Suedia dhe Italia. Danimarka, në anën tjetër, do të ketë zgjedhje më 1 nëntor

Vendet që e kanë mbështetur liberalizimin e vizave, sipas asaj që kanë përcjellë burimet diplomatike, janë: Gjermania, Finlanda, Kroacia, Estonia, Greqia, Hungaria, Portugalia, Polonia, Malta, Luksemburgu dhe Sllovenia.

Austria është shprehur "në favor të vazhdimit të procesit", por ka thënë se nevojiten raporte teknike shtesë.

Çekia, si kryesuese e radhës e BE-së, në takime të tilla duhet të mbajë qëndrim neutral, por në një letër që ua kishte dërguar vendeve anëtare më herët, ishte shprehur qartë se ka ardhur koha për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Përshtypja e diplomatëve është se takimi ka dëshmuar se ekziston një shumicë e madhe në favor të liberalizimit të vizave, ndërsa tash duhet të adresohen shqetësimet e vendeve që kanë shprehur rezerva dhe kanë dalë me disa kërkesa të reja.

Kjo pritet të bëhet edhe në takime direkte që ekspertët e disa prej këtyre vendeve do t'i kenë me përfaqësues të Ministrisë së Brendshme të Kosovës.

Presidenca çeke e Këshillit Evropian tha të enjten se është e domosdoshme që të qartësohen edhe disa çështje, për të çuar përpara liberalizimin e vizave për Kosovën.

Diplomatët thanë se duhet pasur parasysh se ky ishte vetëm fillimi, se vendet anëtare paraqitën vetëm pozicionet fillestare, dhe se duhet parë se si do të rrjedhë diskutimi në të ardhmen. Pra, në këtë moment, nuk duan të flasin për afate kohore apo për qëndrime përfundimtare të vendeve anëtare në Këshillin e BE-së.

Ndërkohë, zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, i ka konsideruar si kushte të reja idetë që janë diskutuar më 13 tetor në grupin punues për vizat në Këshillin Evropian, lidhur me liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. "Edhe pse ata pretendojnë se janë vetëm teknikalitete, për ne janë kushte të reja", ka thënë Bislimi për televizionin ATV në Kosovë.

Komisioni Evropian ka rekomanduar liberalizimin e vizave për Kosovën qysh në vitin 2018.

Më 12 tetor të këtij viti, ky Komision ka konfirmuar në Raportin vjetor të Progresit se mbështet rekomandimin e bërë për heqjen e vizave për Kosovën dhe konstatimin se shteti i ka përmbushur të gjitha kriteret.

Përgatitjet për dimër, ekspertët thonë se masat e qeverisë janë të dobishme por të pamjaftueshme

PRISHTINË, 16 TETOR - Rrahim Beqiri, banor i Prishtinës, merr 110 euro në muaj ndihmë nga shteti, me të cilat mban familjen, gruan dhe djalën 11 vjeç. Ai thotë se në pamundësi për të gjetur një punë të rregullt, me këto të ardhura e ka të vështirë të sigurojë ngrohje për këtë dimër. Viteve të kaluara e kishin ndihmuar miqtë me drunj, por këtë vit me rritjen e çmimeve, gjërat kanë ndryshuar. "Shoqëria m'i kanë dhënë nga dy tri metra viteve të kaluara, por për sivjet asgjë dhe nuk ka shpresë aspak. Me rrymë nëse mundem ta përballoj, nëse jo më duhet vetëm të rri e të shikoj", thotë ai.

Në Kosovë, ku energjia elektrike është burim kryesor për ngrohje, autoritetet kanë paralajmëruar se dimri i këtij viti do të jetë mjaft sfidues për shkak të krizës energjetike botërore, pamundësisë që vendi të përmbushë nevojat e tij me prodhimin e brendshëm

dhe çmimeve të larta të importeve.

Sipas përlogaritjeve mesatare pritet që shpenzimi i energjisë elektrike gjatë dimrit të jetë 4.12 milion megavat orë, derisa prodhimi do të jetë 3.2 milion megavat orë, që i bie se vendit do t'i duhen edhe 722.8 mijë megavat orë energji elektrike nga importi.

Në përpjekje për të përballuar këtë krizë, ministria e Ekonomisë në Kosovë ka paraqitur një plan për mbështetjen financiare të qytetarëve për blerjen e pajisjeve për ngrohje që shpenzojnë më pak.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, deklaroi se paketa ka vlerën e 6 milionë eurove. "Pajisjet që do të subvencionohen nëpërmjet kësaj thirrje përfshijnë kaldajat me biomasë dru, pelet, briket që do të subvencionohen deri në 70 për qind të vlerës së investimit, ose deri në një mijë e 200 euro. Pompat termike të

cilat ulin shpenzimin e energjisë elektrike deri në 70 për qind do të subvencionohen deri në 30 për qind ose deri në dy mijë e 500 euro. Kondicionerët eficient të cilët ulin shpenzimin e energjisë deri në 70 për qind do të subvencionohen deri në 40 për qind të vlerës ose deri në 400 euro. Stufat individuale eficiente me biomasë - dru, të cilat për familjet që janë pjesë e skemës sociale do të subvencionohen deri në 90 për qind", ka thënë Rizvanolli.

Ajo theksoi se me këtë skemë planifikohet të mbështeten rreth dhjetë mijë familje, të cilat do të kursejnë rreth 70 për qind të konsumit të energjisë, që në total i bie rreth 12 milionë euro kursim gjatë këtij dimri.

Mundësia për të përfituar subvencione nga qeveria, ka rritur kërkesën për pajisje të tilla të ngrohjes, thotë Besfort Jakupaj, drejtues i një kompanie që tregton pajisje të tilla. "Nëse

krahasohet kërkesa vitin e kaluar me atë tash nga qytetarët e Kosovës, është përafërsisht diku 30 për qind më shumë. Unë shpresoj që qeveria në vazhdimësi do të ofrojë subvencione të tilla për pompa termike dhe të gjitha paisjet tjera efikente si klimat për banesa, meqë një pjesë e banesave nuk kanë mundësi për vendosje të pompave termike, ndërsa klima është një zgjidhje e mirë për ta që të bëjnë ngrohjen në fazën kalimtare", thotë ai.

Ekspertë të sistemit energjetik thonë se masat e qeverisë janë të dobishme por të pamjaftueshme për të përballuar situatën e krijuar.

Dardan Abazi hulumtues në Institutin për Politika Zhvillimore (INDEP) i tha Zërit të Amerikës se subvencionimi është dashur të nisë më herët. "Ndonëse ne i mirëpresim masat si të tilla, konsiderojmë se ato janë edhe të pamjaftueshme

por edhe të vona si masa. Jemi në muajin tetor kur tashmë fillon sezona e ngrohjes së qytetarëve, moti vetëm se është përkeqësuar, ndërsa vetëm tani ministria e Ekonomisë e ka shpallur këtë skemë. Ne vlerësojmë se kjo u ka lejuar njerëzve shumë pak kohë që edhe të informohen mbi skemën që është hapur, edhe nuk janë ofruar informata të bollshme për qytetarët se si të aplikojnë. Në anën tjetër sasia e cila do të jepet, pra për rreth dhjetë mijë konsumatorë nuk është e mjaftueshme që të zbusë në masën e duhur për këtë vit kërkesën për energji", thotë ai.

Përndryshe, thotë Abazi, Kosova duhet të punojë në planin afatgjatë drejt kalimit në energji të ripërtërishme.

Aktualisht në Kosovë 95 për qind e energjisë prodhohet nga dy termocentrale të vjetra dhe vetëm pesë për qind nga burimet e ripërtërishme si dielli, era apo uji. (VOA)



Zbulohet pllaka me emrat e 15 maturantëve të Malishevës që vdiqën tragjikisht në Fushë Arrëz

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

FUSHË ARRËZ, 16 TETOR - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati dhe kryetarit të Bashkisë së Fushë Arrëzit, Fran Tuci, dhe në prani të ambasadorit të Kosovës në Shqipëri, Skender Durmishi, gjithashtu të familjarëve, profesorëve dhe shokëve të gjeneratës së 15 maturantëve, drejtuesve të institucioneve të Komunës së Malishevës dhe Bashkisë Fushë Arrëz, dhe qytetarëve të shumtë, u shënua 18-vjetori i vdekjes tragjike të 15 maturantëve të Komunës së Malishevës.

Në një fjalë përkujtimore, kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, tha se, data 14 tetor, është data më e dhimbshme për Komunën e Malishevës, pasi në këtë datë të vitit 2004, 15 maturantë të komunës së Malishevës humbën jetën tragjikisht në Fushë Arrëz, gjatë kthimit nga ekskursioni në Shqipëri. “Kjo ngjarje, njëherësh shënon edhe ngjarjen më tragjike në Kosovën e pasluftës,

ku i gjithë kombi shqiptar atë ditë në të gjithë botën ishte i pikëlluar nga ky lajm i hidhur dhe lotët nuk kishin të ndalur, zemrat ishin të thyera, e dhimbja ishte shumë e madhe, jo vetëm për familjet e maturantëve por për të gjithë bashkëkombësit”, ka theksuar Kastrati, duke shtuar se sot në 18-vjetorin e vdekjes së tyre ndjejnë dhembjen me të gjitha familjet e personelin arsimor, dhe gjeneratën e maturantëve, të cilët pësuan 18 vjet më parë duke na lënë me kujtimet e hidhura.

Në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Malishevës, kryetari Kastrati, shprehi mirënjohjen të thellë për angazhimet dhe kujdesin intensiv për autoritetet e shtetit amë shqiptar, me theks te veçante atyre shëndetësore, të cilat u angazhuar dhe i dolën në ndihmë nxënësve, personelit arsimor, familjeve dhe institucioneve të komunës së Malishevës për të përballuar sa më lehtë pasojat tragjike të atij identiteti.

Ndërsa, kryetari i Bashkisë së Fushë Arrëzit, Fran Tuci, në një fjalë përkujtimi mes tjerash tha



se, dy bashkitë tona janë të lidhura ngushtësisht me datën 14 tetor, por të vendosura që të kujtojnë pareshtur këtë udhëtim

të maturantëve, i cili u shndërrua në ngjarje tragjike për gjithë kombin shqiptar, duke mbetur pa 15 maturantë, të cilët sot i

takojnë historisë së arsimit shqip dhe është ngjarje që kombin shqiptar e forcon drejt rrugës së aspiratave tona kombëtare.

Zëvendësimi i orëve gjatë fundjavës, reagon sërish Këshilli i Prindërve

PRISHTINË, 16 TETOR - Vendimi i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për zëvendësimin orëve të humbura gjatë grevës së SBASHK-ut, ka shkaktuar pakënaqësi te sindikata e po ashtu edhe të Këshilli i Prindërve, të cilët po kundërshtojnë një gjë të tillë. Këta të fundit kanë reaguuar sërish duke thënë se janë kundër mbajtjes së procesit mësimor gjatë të shtunave. Përmes një reagimi në “Facebook”, Këshilli i Prindërve të Kosovës ka thënë se për këtë çështje duhet të ketë pajtueshmëri nga të gjitha palët e përfshira. “Politikbërësit e arsimit në Kosovë po gjykojnë që gjashtë ditë rresht mësim janë të mundshme e nuk ka rëndësi a janë dakord për këtë



fëmija e prindërit por edhe mësimdhënësit...Pa dakordësi e pajtueshmëri të argumentuar ne do të vazhdojmë së bëri lëvizje të çrregullta, me efekte

shumëanshmërisht penguese, pa perspektivë shpresëdhënëse se arsimit publik në këtë vend mund (e do) të dalë nga prapambeturia, jokohërenca e

padobishmëria”, thuhet në reagim.

Ndryshe, SBASHK-u ka theksuar se MASHTI që në fillim të javës që po vjen duhet të mbajë

takim urgjent me përfaqësues të Asociacionit të Komunave, të kolegjiutit të drejtorive komunale të arsimit, të Këshillit të Prindërve dhe SBASHK-ut për të bërë përpjekje të përbashkëta dhe për të arritur marrëveshje të pranueshme lidhur me orët e humbura në grevë, MASHTI ka bërë thirrje për kompensimin e orëve të humbura gjatë të shtunave, ndërkaq kundër kanë dalë edhe Sindikata e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK). Ndryshe, greva në tërë sektorin e arsimit kishte filluar më 25 gusht dhe është pezulluar më 1 tetor. Kërkesa kryesore e tyre ishte shtesa nga 100 euro deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga. Greva u pezullua deri në janar të vitit të ardhshëm dhe kjo u bë pa marrëveshje me Qeverinë.

“Zip Line Green Valley”, mundësi për zhvillim në sferën e turizmit dhe tërheqjen e shumë vizitorëve

GJILAN, 14 TETOR - Drejtori për Zhvillim Ekonomik (DZHE) në Gjilan, Enver Shabani, ka vizituar “Zip Line Green Valley” në fshatin Pogragjë të komunës së Gjilanit, ku gjatë bashkëbisedimit me pronarin e këtij biznesi, u informua për lidhur me numrin e vizitorëve si dhe

planet investuese në të ardhmen për zgjerimin e kapaciteteve.

Drejtori Shabani tha se “Zip Line Green Valley” ofron aventurë e adrenaline dhe, mbi të gjitha, pamje të bukur të ambientit me të cilin rrethohet. “Ky lokacion paraqet mundësi të mëdha për zhvillim në sferën e

turizmit dhe tërheqjen e shumë vizitorëve nga Kosova dhe jashtë. Drejtorja për Zhvillim Ekonomik i ofroi përkrahje institucionale për zhvillimin e aktiviteteve dhe zgjerimin e kapaciteteve zhvilluese”, ka theksuar drejtori i DZHE-së, Enver Shabani.



Mustafa përmend disa nga arsyet e rënies ekonomike: Viti aktual parashihet të jetë sfidues



Prishtinë, 16 tetor - Ish-kryeministri Isa Mustafa ka bërë me dije se vitin që e lamë pas, Kosova shënoi rritje ekonomike prej 9.5% (sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar) përkatësisht 9.1% (sipas Bankës Botërore). Sipas tij, kjo rritje erdhi si rezultat i rritjes së prodhimit, fuqizimit të konsumit dhe rritjes së eksportit, pasi që në vitin 2020, si pasojë e pandemisë kishin stagnuar të gjitha aktivitetet ekonomike dhe përfunduar me rritje negative ekonomike prej -5.5%. “Në këtë aspekt krahasimet me vitin 2020

janë të natyrës formale, prandaj edhe nuk janë tregues i qëndrueshëm. Nga tregjet dhe ekonomitë në zhvillim në Evropë vitin e kaluar, Mali i Zi kishte rritjen më të madhe ekonomike prej 13% (sipas FMN-së) përkatësisht 12.4% (sipas BB) pasuar nga Kroacia prej 10.2%. Por sikurse Mali i Zi ashtu edhe Kroacia kishin pësuar rënie të madhe ekonomike në kohë të pandemisë (2020)”, ka shkruar Mustafa në “Facebook”. Sipas tij, viti 2022 parashihet të jetë sfidues për Kosovën.

“Vlerësimet e këtij muaji nga FMN flasin se Kosova do të përmbyllë këtë vit me rritje ekonomike prej vetëm 2.7%. Rritje më të ulët (2.4%) parashihet të ketë vetëm Bosnja dhe Hercegovina. Shkak i kësaj rënie vlerësohet të jetë inflacioni i lartë, bilanci i pavolitshëm tregtar, rënia e investimeve publike dhe atyre private, rënia e konsumit për shkak të rritjes së çmimeve duke mbajtur pagat e pandryshuara në sektorin publik dhe ndikimi indirekt nga lufta në Ukrainë”, ka shkruar Mustafa.

Mehmeti: Po bëjmë përpjekje që të mos ketë rritje të normave të interesit në kredi

PRISHTINË, 16 TETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti ka thënë se parashikimi për rritjen ekonomike në vend aktualisht është rreth 3 për qind, një rënie e thellë në krahasim me rritjen 10.75 për qind në vitin 2021. Në një intervistë për “Zërin e Amerikës” Mehmeti, i cili ndodhet në Uashington për takimet e vjeshtës së Bankës Botërore dhe FMN-së, ia atribuon në masë të madhe pasojave në vend dhe në shkallë globale të agresionit rus në Ukrainë. “Këtë vit dhe vitin e ardhshëm jemi duke bërë parashikime më të shpeshta, varësisht prej situatës që po krijohet si rezultat i agresionit rus në Ukrainë”, tha ai. Guvernatori Mehmeti thotë se në këtë kontekst duhet parë edhe inflacioni i lartë që në gusht ishte 13.1 për qind dhe pasojat negative. “Ndryshimet dinamike në nivel global janë shoqëruar me rritje të inflacionit, me ndryshim të politikave monetare, pastaj ngadalësim të rritjes botërore për arsye se pati një shkopitje të zinxhirit të furnizimit dhe të gjitha këto ndikuan në

aktivitetin ekonomik në nivel të Kosovës por edhe në nivel global”, tha ai. Mehmeti nënvizoi se bashkë me pjesën më të madhe të mallrave dhe shërbimeve, Kosova importon edhe inflacionin. “Vetëm deri në gusht, në korrik realisht kemi pasur në total importimin e mallrave dhe shërbime diku tek rreth 3.75 miliardë euro, 2.94 miliardë euro mallra i kemi importuar, prandaj dhe inflacionin e importojmë dhe për këtë arsye mundësia jonë për të ndikuar tek inflacioni, jo vetëm në Kosovë por edhe edhe Banka Evropiane dhe ajo amerikane, janë të vogla”, tha ai. Mehmeti tha se edhe pse Kosova nuk importon direkt drithë nga Ukraina, fakti që 80-85 për qind e importeve eksportive bëhet me vendet e Evropës, ndikon në mënyrë indirekte. “Vendet e Evropës deri diku janë të ndikuara sepse importojnë rreth 40 për qind të drithërave nga Ukraina, kanë edhe lidhje të tjera tregëtare dhe kjo në mënyrë indirekte ndikon edhe në Kosovë”, tha ai duke shtuar se vendi po merr masa t’i zëvendësojë ato mallra



që ndikohen edhe nga shkopitjet e zinxhirit të furnizimit. Lidhur me sektorin bankar, guvernatori tha se vazhdon të jetë i kapitalizuar mirë dhe se

megjithëse në Evropë ka pasur rritje të përqindjes së normës së interesit, Kosova po përpjeket ta shmangë një gjë të tillë. “Ne jemi duke bërë përpjekje si Bankë Qendrore, brenda

mandatit tonë ligjor dhe kushtetues që të mos ketë rritje të normave të interesit në kredi”, tha ai. Aktualisht kjo normë është 6.1 për qind.

Shtresa e mesme sociale në Gjermani mes frikës nga rënia ekonomike, inflacioni po i ‘gërryen’ pagat



BERLIN, 16 TETOR - Çmimet në Gjermani po rriten, veçanërisht ato të energjisë elektrike. Inflacioni i ha pagat. Kriza mund të tronditë themelet e shoqërisë: shtresën e mesme. Ata janë shumë dhe deri tani kanë jetuar mirë: mësues, nëpunës, zejtarë. Grupi i njerëzve me të ardhura të mesme, shtylla e shoqërisë gjermane që ka mbështetur vendin për shumë vite. Se kush saktësisht është pjesë e saj, për këtë ka përkufizime të ndryshme, që bazohen tek të

ardhurat që janë në dispozicion. Sipas përlogaritjeve të Institutit Gjerman të Ekonomisë (IW), në vitin 2019 të ardhurat e tyre ishin rreth 1,700 deri në 3,100 euro në muaj për një person beqar dhe 3,540 deri në 6,640 euro për një çift me dy fëmijë. Shtresa e mesme gjeneron një pjesë të madhe të të ardhurave tatimore, të cilat nevojiten për të garantuar shtetin e mirëqenies dhe shtetin social, zakonisht kanë më shumë besim te demokracia dhe

garantojnë një shkallë të caktuar stabiliteti. Është e dëshirueshme që shumë njerëz të jenë pjesë e shtresës së mesme. Madje, është aq e dëshirueshme që edhe disa njerëz që në fakt nuk i përkasin kësaj shtrese në aspektin socio-ekonomik të llogariten mes tyre. Po ashtu, Fondacioni Bertelsmann dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) theksojnë se 73 për qind e qytetarëve në Gjermani e përkrahajnë veten si pjesë e shtresës së mesme.

Shpikësi i mikroprocesorit: Ja pse nuk krijojmë dot asgjë që t'i afrohet inteligjencës origjinale të qenies njerëzore

"Unë, njeriu i kompjuterit ju them: ndërgjegja është krejt tjetër gjë"



Nga Eleonora BARBIERI

Federiko Fagin buzëqesh: "Dikush mund të mendojë se libri "I pamodifikueshëm" më referohet mua ...". "Në fakt ai ka lidhje me raportin midis ndërgjegjes dhe materies, pra makinerive që krijojmë ne njerëzit. Dhe është dekurajues për mbështetësit e zjarrtë të Inteligjencës Artificiale"- shton ai. Fagin e nisi karrierën e tij në "Institutin Teknik Industrial" Rosi në Vicenza (qyteti ku lindi në vitin 1941). Më pas u diplomua për fizikë në Universitetin e Padovës. Nisi punë në Itali në një kompani që prodhonte gjysmëpërçues. Më pas vendos të ndjekë "disa projekte në Shtetet e Bashkuara", dhe pikërisht atje arriti të shpikë mikroprocesorin e pari në botë, Intel 4004. pra një mjeshtër i informatikës (Barak Obama i dha atij Medaljen Kombëtare për Teknologjinë dhe Inovacionin në 2010).

Le ta nisim këtë intervistë nga fillimet tuaja, nga bota e kompjuterave. Kur shkuat në Amerikë?

Ishte viti 1968. Në atë kohë punoja për kompaninë "SGS Fairchild", që merrej me prodhimin e qarqeve të integruara bipolare. Atje shpika një proces të ri për të prodhuara qarqe me një hyrje prej silikoni.

Pse ishte kaq e rëndësishme kjo shpikje?

Sepse brenda 15 vitesh ajo zëvendësoi teknologjinë bipolare, e cila dominonte në qarqet e integruara, duke bërë të mundur krijimin e qarqeve të integruara më komplekse, 5 herë më të shpejtë dhe me një fluks

qarkullimi 100-1000 herë më të mirë.

Pastaj?

Më pas kalova tek "Intel", ku falë teknologjisë së "Silicon Gate", shpika mikroprocesorin. Këto 2 shpikje e ndryshuan historinë e gjysmëpërçuesve. Dhe me kompaninë "Zilog", të cilin e themelova në vitin 1974, krijova një mikroprocesor tjetër, Z80, që ishte shumë i suksesshëm dhe vazhdon të prodhohet ende sot.

A jeni shumë i pasur?

Po. Le të themi se para se të mbushja 40-vjeç, kisha mjaftueshëm para për të mos punuar më.

Dhe në vend të kësaj...

Themelova kompaninë tjetër "Synaptics". Doja që të krijoja qarqe të integruara për kompjutera që mund të mësonin vetë. Pra po flas për sistemet e inteligjencës artificiale. Kam punuar gjatë mbi këtë fushë edhe pse në ato kohë ky sektor nënvlerësohej. Nisa të prodhoja teknologji që funksiononin vetëm me prekje por edhe ekrane me prekje.

A mund të thuhet se keni marrë një kënaqësi të madhe nga bota e makinerive?

Po, por kishte një problem. Edhe pse kisha arritur gjithçka që bota pretendon se mjafton për të qenë i lumtur, unë nuk isha. Pasi tani që kisha bërë gjithçka, ndihesha si përhumur. Prandaj fillova të studioj ndërgjegjen.

Nga cili këndvështrim?

Në atë kohë isha materialist, ndaj

thashë me vete: Nëse truri është një objekt, si kompjuteri, edhe ky i fundit duhet të ketë ndërgjegje. Dhe po përpiqesha të kuptoja se si. Pastaj vura re se tekstet e neuroshkencës e përshkruanin vetëdijen si përvoja që kemi kur shohim një peizazh, nuhasim një parfum apo dëgjojmë muzikë, pra si fryt i sinjaleve elektrike dhe biokimike. Dukej sikur këto sinjale përkonin me përvojën tonë të ndërgjegjshme.

Në çfarë përfundimi arritët?

Që fjala ndërgjegje ishte e padëshiruar, dhe se ajo për të cilin flisnin ata ishte një mashtrim. Njëlloj si sot me Inteligjencën Artificiale: ata na flasin për gjërat që bëjnë kompjuterat, sikur këta i bëjnë ato vetë dhe jo të programuar nga ne. Për më tepër, kompjuterat e bëjnë këtë si makineri. Ato kanë brenda vetëm sinjale. Është një formë indoktrinimi, ku vetëdija identifikohet me një fenomen material, i cili lind nga një mekanizëm, nga faktorë biologjikë, kur në fakt nuk është kështu.

Si e bëtë këtë zbulim?

Siç e kam shpjeguar në librin tim të parë "Silicio", unë pata një përvojë të jashtëzakonshme, të cilën e quaj zgjim, e cila më bëri të kuptoj se si vetëdija ishte shumë më tepër se sa mendoja, dhe më hapi një portë drejt një bote tjetër, atë të spiritualitetit, të cilën e kisha eliminuar. Është një botë që ka një kontakt të fortë me fenë, dhe më ka nxitur të nis një rrugëtim, i cili zgjati 20 vjet, mbi natyrën e ndërgjegjes, meditimit... Unë i kam përjetuar të gjitha ndjesitë, por pa përdorur asnjë lloj droge.

Dhe ku ju çoi kjo rrugë?

E kuptova që vetëdija nuk mund të jetë një fenomen i fizikës klasike. Në moshën 68-vjeçare dola në pension për t'iu përkushtuar studimit të ndërgjegjes. Në vitin 2009 krijova Fondacionin Federiko dhe Elvia Fagin, për të kuptuar fizikën e ndërgjegjes, Jo vetëm metafizikën, por edhe për të ndërthurur aspektet shpirtërore dhe shkencore, për të krijuar një urë lidhëse midis të dyjave, diçka që sot cilësohet e pamundur.

Si arrin t'i mbash ato së bashku?

Që të dyja kombinohen shumë mirë për të krijuar një vetë-njohje, e cila nuk do të ishte e mundur vetëm përmes realitetit fizik, simbolik. Në fakt kjo e fundit integrohet me përvojën e brendshme, që është realiteti kuantik.

Çfarë thotë fizika kuantike për përvojat e brendshme të njeriut?

Që informacioni kuantik nuk mund të dhurohet: Ai përfaqëson përvojën e sistemit që është në atë gjendje kuantike, e cila është private, pra një përvojë e brendshme e ndërgjegjes. Tek e fundit, ne e dimë mirë se sa unike është përvoja jonë.

A është kjo ajo që ju e quani Seity?

Seity është entiteti i ndërgjegjshëm: Pra sistemi kuantik që është i vetëdijshëm, që mund të veprojë me vullnet të lirë dhe ka një identitet, që është i vetëdijshëm.

Po materia?

Materia ka realitetin e vet, që është informacioni klasik. Pra është ajo që i lejon Seity të komunikojë, përmes simboleve të ndashme, të tilla si pjesët e kompjuterit ose fjalët, në mënyrë që të gjithë të kemi qasje këtë informacion. Pra, ne sjellim një kuptim mbi fizikën, duke krijuar një lidhje midis brendësisë – fizikës kuantike – dhe eksterioritetit – fizikës klasike.

Një formë idealizmi?

Po, por jo shumë i madh. Fakt është se kjo teori ecën në drejtim të kundër me materializmin që është sot dominues. Ndaj kjo teze do të hasë shumë rezistencë. Do të duhen të paktën 30 ose 40 vjet. Por ne do të arrijmë atje.

Në këtë pikë, a mund të quhet vërtet inteligjencë ajo që quajmë sot Inteligenca Artificiale?

Jo, sepse inteligenca e vërtetë ka nevojë për vullnet të lirë, dhe për atë aspekt jo-algoritmik që quhet krijimtari.

Po alarmet në kompjuterat që do të na monitorojnë?

Mendoj se gjërat që ata thonë mund të ndodhin, jo sepse kompjuteri dëshiron që të fitojë kontroll mbi ne njerëzit, por sepse njeriu, ai që kontrollon kompjuterat, dëshiron që t'i nxitë makinat ta bëjnë këtë. Kompjuterat nuk mund të vendosin për asgjë. Është një shpëlarje truri, që kryhet përmes përdorimit të ideve të gabuara, për të fituar para dhe për ta shfrytëzuar informacionin tonë. / "Il Giornale" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Ballkani regjistron barazimin e parë, Llapi merr një pikë në Mitrovicë, Gjilani fiton si mysafir



PRISHTINË, 16 TETOR - Kampioni në fuqi, Ballkani ka regjistruar barazimin e parë në këtë edicion në Albi Mall Superligë. Skuadra portokallezi, e cila sivjet po e përfaqëson futbollin tonë në mënyrë dinjitoze në UEFA Conference League, të dielën, në Skenderaj, ka barazuar me Drenicën, 1:1, në kuadër të javës së 11-të. Kuqezinjtë kaluan të parët në epëris me golin e Osman Mziut, në minutën e 54-t, por skuadrën suharekase nga

humbja e shpëtoi Armend Thaqi, me një supergol në minutën e 81-të. Pa fitues u mbyll edhe ndeshja në stadiumin "Riza Lushta", ku Trepça'89 dhe Llapi u ndan baras, 3:3. Golat për Trepçën'89 i shënuan Ardian Muja (23'), Bleon Sekiraga (53') dhe Armend Gashi (72'), derisa për llapjanët shënuan Kushtrim Shabani (49'), Drilon Fazliu (71') dhe Festim Alidema (91'-p). Ndërkohë, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Liman

Gegaj" fitores iu gëzua Gjilani, që e mundi Malishevën vendase, me rezultat 1:0. Golin e vetëm në ndeshje e realizoi Theophilus Solomon në minutën e 51-të. Malisheva pati mundësi për të barazuar shifrat por gjuajtjen e Alban Shillovës nga penalltia e priti Enea Koliqi. Në ndeshjet e zhvilluara të shtunën, Prishtia realizoi fitoren e parë në "Fadil Vokrri", duke e mposhtur Ferizajn, 2:1, derisa Drita shënoi fitore si mysafir ndaj Dukagjinit (1:0).

Peja mposhti Bashkimin për fitoren e gjashtë radhazi

PRIZREN, 16 TETOR - Peja ka regjistruar edhe fitoren e gjashtë radhazi nga po aq ndeshje të zhvilluara deri më tani në Superligën e Kosovës në basketboll.

Në ndeshjen e javës së gjashtë, skuadra e drejtuar nga Can Sevim fitoi në udhëtim kundër Bashkimit.

Ndeshja e zhvilluar në palestrën "Sezai Surroi" përfundoi me rezultatin 67:72.

Për Bashkimin ishte humbja e katërt, krahas dy fitoreve.

Brad Waldow me 15 pikë dhe Isiah Umipig me 13 sosh, ishin dy basketbollistët më të dalluar në fitoren e pejanëve. Te prizrenasit u dallua Curtis Jones me 19 pikë.

Peja pas kësaj fitore ka 12 pikë dhe vazhdon të jetë lidere në



tabelë, kurse Bashkimi renditet i pesti me 8 pikë. Në javën e ardhshme, Peja e pret Rahovecin

– kurse Bashkimi luan në udhëtim kundër Golden Eagle Yllit.

Bayerni fiton me rezultat të thellë kundër Freiburgut

Pas barazimit me Borussia Dortmundin javën e kaluar, Bayern Munichi u rikthye te fitorja në Bundesligë këtë të diel. Në ndeshjen e vlefshme për javën e dhjetë, "Bavarezët" fituan me rezultat bindës kundër Freiburgut.



Ndeshja e zhvilluar në "Allianz Arena" përfundoi me rezultatin 5:0.

Serge Gnabry (13'), Eric Maxim Choupo-Moting (33'), Leroy Sane (52'), Sadio Mane (55') dhe Marcel Sabitzer (80') shënuan golat e fitores për kampionët gjermanë.

Bayerni pas kësaj fitore ka 19 pikë dhe renditet i dyti në tabelë, me katër pikë më pak se skuadre lidere, Union Berlini. Kurse, Freiburgu është i treti me 18 pikë.

Liverpooli ia shkakton humbjen e parë sezonale Cityt

Liverpooli i është gëzuar fitores ndaj Manchester Cityt (1-0) në Anfield duke ia shkaktuar humbjen e parë sezonale kampionit në fuqi të Ligës Premier. Në 45 minutat e para të sfidës së zhvilluar në



Anfield, asnjëra nga skuadrat nuk arriti ta gjente rrjetën. Diogo Jota në një rënë ane e Erling Haaland në anën tjetër, vazhduan me rastet e kësaj sfide. Dhe më në fund rezultati u zhblllokua në minutën e 76-të.

Një asistent i mrekullueshëm nga portieri Alisson drejt Mohamed Salah, i cili shkoi përpara dhe e shënoi golin e epërsisë për vendasit.

Pas kësaj humbjeje, Manchester City ka mbetur katër pikë prapa Arsenalit në garën për titull, derisa Liverpooli është ngjitur në vend të tetë në tabelë me 13 pikë të grumbulluara.

Drake humbet skedinën, e lë Barcelona

Këngëtari kanadez Drake është një fans i çmendur i futbollit por ai ka humbur skedinën. Këtë të dielë ai ishte i pranishëm në "Santiago Bernabeu" për ndeshjen El Clasico pasi marka e tij do të jetë në fanellën e katalanasve për shkak të bashkëpunimit me Spotify, por katalanasit u mposhtën 3-1.



Drake vendosi një skedinë prej 617 mijë euro për fitoren e Barcelonës duke e kombinuar edhe me suksesin e Arsenalit në tranefertën e Leeds, ku Topçinjtë fituan 0-1.

Nëse skedina do të dilte, Drake do të fitonte plot 2.8 milionë euro.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

